# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6796
E enjte, 5 janar 2023
çmimi 0.40 €


## Në muajin mars pritet të fillojë gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# KËSHILLTARI I SCHOLZIT DHE AI I MACRONIT DO TA VIZITOJNË KOSOVËN PËR TA KONKRETIZUAR ÇËSHTJEN E DIALOGUT

FAQE 4-5



Ende nuk ka datë të caktuar rreth vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi pas uljes së tensioneve me heqjen e barrikadave të cilat ishin vendosur nga serbët lokalë në veri. Megjithatë, këshilltari i kancelarit gjerman Olaf Scholz, Jens Plettner dhe ai i presidentit të Francës, Emmanuel Macron, Emmanuel Beaune, do të qëndrojnë në Prishtinë në muajin janar për ta përshpejtuar procesin e dialogut përmes planit të njohur si franko-gjerman. Bëhet me dije se atyre do t'u bashkohet edhe emisari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Ish-kryenegociatorja e dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka thënë se plani franko-gjerman nuk e ka njohjen reciproke mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, prandaj nuk duhet të pranohet f. 4-5



## JA SI MUND TË NDRYSHOHET GJENDJA NË KËTË VEND

Shkruan:
Milazim Krasniqi

FAQE 7



## LARGOHEN BARRIKADAT E MBETURA NË VERI

FAQE 3

## AKTUALE




### OSMANI: RUSIA DUHET T'I RESPEKTOJË PARIMET E OSBE-së NËSE DËSHIRON DIALOG F. 2

### LËSHOHEN NË HAPËSIRË SATELITËT 'ALBANIA 1' DHE 'ALBANIA 2' F. 6

### NGJARJE TRAGJIKE NË PRIZREN, VRITET NJË SHTETAS I SHQIPËRISË, NDALOHEN PËR 48 ORË GJASHTË TË DYSHUAR F. 6

## EKONOMI



### NJË VIT LUFTË ME INFLACIONIN: CILAT JANË PARASHIKIMET PËR 2023-SHIN? F. 8

### NGA 1 JANARI STIKERSAT ME NGJYRË TË GJELBËR F. 8

## SPORT



### LLAPI ANGAZHON TRAJNER TË PORTIERËVE F.12


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Osmani: Rusia duhet t'i respektojë parimet e OSBE-së nëse dëshiron dialog

**Shkup, 4 janar** - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha se lufta në Ukrainë do ta dominojë kryesimin e Maqedonisë së Veriut me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).
Osmani tha më 4 janar se komunikimi me Rusinë dhe nëse do të vendoset një dialog thelbësor do të varet nga qëndrimi i Moskës ndaj parimeve dhe angazhimeve të OSBE-së. "Ne si kryesues nuk do të lejojmë asnjë kompromis sa iu përket parimeve të OSBE-së që duhet të respektohen nga Rusia", tha Osmani në një konferencë për medie teksa prezantoi prioritetet që do të jenë në fokus të kryesimit njëvjeçar të Shkupit me OSBE-në.
Ai tha se aktualisht nuk ka mision të OSBE-së në Ukrainë pasi Rusia vendosi veton ndaj misionit, por se Maqedonia e Veriut, sipas tij, do të duhet të gjejë një mënyrë për ta kthyer OSBE-në në Ukrainë. "Ne do të duhet të gjejmë një mënyrë se si ta rikthejmë OSBE-në në Ukrainë si të kontribuojmë për të bërë të mundur fillimisht vendosjen e paqes dhe më pas, natyrisht, për ta zbatuar paqen dhe për t'ua lehtësuar jetën njerëzve. Fokusi do të jetë në mënyrën se si do të komunikojmë me Rusinë. OSBE-ja mund të jetë aktualisht e vetmja organizatë ku ka një lloj komunikimi me Rusinë dhe ne po komunikojmë me Rusinë, megjithatë në Vjenë, por se si do




të jetë qasja e Rusisë ndaj parimeve dhe angazhimeve të OSBE-së", ka deklaruar Osmani.
Ai theksoi se "ky mesazh i është dërguar qartë Rusisë dhe nëse vendos, t'i kthehet bashkësisë ndërkombëtare, nëse vendos t'u kthehet zotimeve dhe parimeve të bashkësisë ndërkombëtare, ndalesa e saj e parë do të jetë OSBE-ja dhe ne do të jemi këtu".
Fryma bazë e prioriteteve të Shkupit gjatë kryesimit me OSBE-në, sipas shefit të diplomacisë maqedonase, do të jetë forcimi i misioneve të OSBE-së. Nga gjithsej 12 misione të organizatës, theksoi Osmani, gjashtë janë në territorin e Ballkanit Perëndimor, nga të cilat dy më të mëdhatë janë në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë. Në këtë kontekst, sipas tij, "fokus i veçantë do t'u kushtohet të ashtuquajturave konflikte të ngrira të cilat për momentin mund të jenë të qeta, por nuk e dimë se kur mund të shpërthejnë".
Osmani tha se veç kësaj OSBE-ja si prioritet do ta ketë edhe sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit si një çështje serioze që përcakton sigurinë.

# Sunak i premton Zelenskyt mbështetje afatgjatë për Ukrainën



**Londër, 4 janar** - Kryeministri britanik Rishi Sunak i ka thënë presidentit Volodymyr Zelensky se Ukraina mund të llogarisë në mbështetjen afatgjatë të Britanisë së Madhe. Sipas njoftimit nga zyra e Sunakut, biseda mes liderëve ndodhi më 3 janar pas sulmeve të fundit me dronë nga Rusia.
Rusia që nga tetori po kryen sulme me dronë dhe raketa ndaj infrastrukturës energjetike të Kievit, duke lënë miliona ukrainas pa furnizim me rrymë.
Sunak vizitoi për herë të parë Kievin në nëntor, pasi mori detyrën në fund të tetorit.
Gjatë vizitës në Ukrainë ai tha se Londra do t'i japë Kievit ndihmë ushtarake në vlerë prej 59.4 milionë dollarësh, duke përfshirë armë kundër-ajrore dhe teknologji anti-dronë.
Ish-kryeministri britanik Boris Johnson kishte deklaruar në korrik se mbështetja britanike për Ukrainën "nuk do të lëkundet" pavarësisht se kush do të bëhet kryeministër i ardhshëm i vendit të tij. Këtë e kishte thënë edhe pasardhësja e tij, Liz Truss, e cila qëndroi në pushtet vetëm 44 ditë.
Britania, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë sanksionuar individë të ushtrisë iraniane dhe kompani të mbrojtjes për përfshirjen e tyre në furnizimin e Rusisë me dronë iranianë.
Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.
Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.
Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

# Për herë të parë në 100 vjet dështon zgjedhja e kryetarit të Dhomës së Përfaqësuesve

**Uashington, 4 janar** - Ka dështuar zgjedhja e kryetarit të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, diçka që nuk është parë qe një shekull.
Udhëheqësi republikan Kevin McCarthy dështoi në përpjekjen e tij për t'u zgjedhur kryetar - hera e parë që nga viti 1923, që asnjë kandidat republikan apo demokrat nuk u zgjodh që në raundin e parë të votimit në postin e kryetarit të Dhomës së Përfaqësuesve, e cila ka 435 anëtarë. Ai nuk arriti të zgjedhet kryetar pas tri raundesh votimi, ku 20 ligjvënës konservatorë votuan kundër kandidaturës së kolegut të tyre republikan.
Kongresisti nga Kalifornia nuk u votua tri herë radhazi dhe është e paqartë se cila mund të jetë rruga e tij drejt fitores, kur Dhoma e Përfaqësuesve të mblidhet të mërkurën, për të provuar gjithçka nga e para.
Ligjvënësit amerikanë do të vazhdojnë të votojnë derisa një kandidat ta fitojë shumicën.
Ende nuk dihet nëse do të ndryshojë qëndrimi i grupit që e kundërshtoi McCarthyn, apo nëse mund të shfaqet ndonjë kandidat i ri.
Por, edhe nëse McCarthy gjen një mënyrë për të fituar, analistët parashikojnë trazira në Dhomën e Përfaqësuesve.
Republikanët kanë fituar një



shumicë të ngushtë, 222-212, në Dhomën e Përfaqësuesve, pas zgjedhjeve të mesmandatit, ndërsa një vend është momentalisht vakant.
McCarthyt, i cili shërben prej 16 vjetësh si ligjvënës nga Kalifornia, do t'i duhet të sigurojë të paktën 218 vota për t'u bërë kryetar.
Në raundin e tretë të votimit, 202 republikanë votuan për McCarthyn, pra 16 më pak nga votat që i nevojiten për t'u zgjedhur kryetar.
McCarthy, 57-vjeçar, është përpjekur prej vjetësh të marrë drejtimin e Dhomës së Përfaqësuesve. Gjatë javëve të fundit ai u takua në mënyrë të përsëritur me kundërshtarët e tij republikanë për ta siguruar mbështetjen e tyre për kandidaturën e tij për kryetar.
Kushdo qoftë ligjvënësi që republikanët do të zgjedhin për kryetar, McCarthy apo dikush tjetër, ai do ta zëvendësojë kryetaren demokrate në largim, Nancy Pelosi, e cila do të vazhdojë të jetë ligjvënëse.
Zgjedhja e kryetarit të Dhomës së Përfaqësuesve ndodh përpara se ligjvënësit ta bëjnë betimin për mandatin e tyre dyvjeçar.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Largohen barrikadat e mbetura në veri

Mitrovicë, 4 janar - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX, dhe Policia e Kosovës i kanë larguar më 3 janar barrikadat e krijuara me kamionë, te vendi i njohur si Shkëmbi i Dudës në Mitrovicën e Veriut.

Ura, e cila ishte e bllokuar atje prej ditësh nga serbët lokalë, tashmë është liruar për qarkullim.

KFOR, i cili të martën njoftoi për zhvillimin e "operacioneve inxhinierike" në veri të Kosovës, për t'i hequr automjetet që ende po i bllokonin rrugët, ka kryer bartjen e kamionëve të larguar nga rruga.

Kamionët në këtë lokacion në Mitrovicë të Veriut ishin djegur më 29 dhjetor.

Në njoftimin e KFOR-it në "Twitter" u tha se operacioni për largimin e automjeteve të bllokuara në rrugë po bëhej për ta rikthyer lirinë e lëvizjes në atë zonë.

Për 20 ditë me radhë, në dhjetor të vitit 2022, në katër komunat veriore të banuara me shumicë serbe, u vendosën barrikada në rrugët që çojnë drejt pikave kufitare Kosovë - Serbi.

Barrikadat u vendosën në shenjë pakënaqësie me arrestimin e një ish-polici serb të Kosovës, i cili, sipas autoriteteve të Kosovës, dyshohet për organizimin e një sulmi ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri.

Por, serbët vendosën t'o heqin barrikadat pasi Dejan Pantiqit iu ndryshua masa e sigurisë nga paraburgim në arrest shtëpiak.

Po ashtu, përfaqësuesit e serbëve në Kosovë, gjatë një takimi në Rashkë të Serbisë me presidentin serb Aleksandar Vuçiq më 28 dhjetor, deklaruan se kanë marrë garanci që kërkesat e serbëve për heqjen e barrikadave do të plotësoheshin.




# Lëshohen në hapësirë satelitët 'Albania 1' dhe 'Albania 2'




TIRANË, 4 JANAR - Janë lëshuar në hapësirë satelitët "Albania 1" dhe "Albania 2". Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka postuar në "Facebook" momentin kur satelitët janë lëshuar në hapësirë nga Cape Canaveral në Florida.

Rama ka thënë se nga tani Shqipëria ka më shumë aftësi të teknologjisë së lartë për të kontrolluar, mbrojtur e administruar territorin e saj. "Ja dhe kjo, u tha, u bë. Sapo është lëshuar nga Cape Canaveral, Florida raketa 'Falcon 9', misioni i përbashkët i 'SpaceX Transporter 6' që transporton për në hapësirë edhe satelitët tanë, 'Albania 1' dhe 'Albania 2'. Nga sot Shqipëria ka më shumë aftësi të teknologjisë së lartë për të kontrolluar, mbrojtur e administruar territorin, duke siguruar në kohë reale të dhëna të rëndësishme në një sërë aspektesh kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm", ka shkruar Rama krahas videos ku satelitët shihen duke u lëshuar në hapësirë.

Më 20 tetor të vitit 2021 Rama kishte deklaruar se Shqipëria do të dërgonte dy satelitë në hapësirë. Kryeministri Rama asokohe kishte thënë se dy satelitët do të shërbenin për çështje civile të vendit duke survejuar territorin e plotë të Shqipërisë.

Ndërsa marrëveshja në mes të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Operatorit "Saterllogic USA Inc" është firmosur nga Rama më 29 shtator të vitit 2022.

# Von Cramon tregon se si mund të votojnë shtetet mosnjohëse të Kosovës në Këshill të Evropës

Prishtinë, 4 janar - Raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovën, Viola von Cramon, është deklaruar lidhur me mundësinë që shtetet mosnjohëse të Kosovës të votojnë për pranimin e saj në Këshillin e Evropës.

Zëvendësministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Kreshnik Ahmeti, ka thënë të martën se Kosova ka siguruar votat e mjaftueshme si dhe interpretimin ligjor që sqaron se nuk ka pengesa që Kosova të anëtarësohet në KiE.

Teksa e ka komentuar këtë deklaratë, politologu Jasmin Mujanoviq ka thënë se është interesante të shihet se si do të votojnë pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin Kosovën, por edhe Ukraina dhe Bosnja.

"Zëvendësministri i Jashtëm i Kosovës thotë se qeveria ka siguruar mjaftueshëm vota që të pranohet në Këshillin e Evropës. Do të ishte arritje e madhe diplomatike për Prishtinën nëse është e saktë. Nëse ky zhvillim rezulton në votim formal në Këshill, atëherë do të ishte veçanërisht interesant për të parë si votojnë pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin Kosovën, por edhe Ukraina e Bosnja", ka shkruar Mujanoviq në "Twitter".

E Von Cramon është përgjigjur për këtë mundësi. "Shumica e tyre në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës nuk do të marrin pjesë në votim apo, në rastin më të keq, do të votojnë kundër. Kjo është së paku ajo që kam dëgjuar", ka shkruar Von Cramon në "Twitter".





# Këshilltari i Scholzit dhe ai i Macronit do ta vizitojnë Kosovën për ta konkretizuar çështjen e dialogut

Ende nuk ka datë të caktuar rreth vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi pas uljes së tensioneve me heqjen e barrikadave të cilat ishin vendosur nga serbët lokalë në veri. Megjithatë, këshilltari i kancelarit gjerman Olaf Scholz, Jens Plettner dhe ai i presidentit të Francës, Emmanuel Macron, Emmanuel Beaune, do të qëndrojnë në Prishtinë në muajin janar për ta përshpejtuar procesin e dialogut përmes planit të njohur si franko-gjerman. Bëhet me dije se atyre do t'u bashkohet edhe emisari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Ish-kryenegociatorja e dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka thënë se plani franko-gjerman nuk e ka njohjen reciproke mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, prandaj nuk duhet të pranohet

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

**Prishtinë, 4 janar** - Këshilltari i kancelarit gjerman Olaf Scholz, Jens Plettner dhe ai i presidentit të Francës, Emmanuel Macron, Emmanuel Beaune, do të qëndrojnë në Prishtinë gjatë muajit janar për ta përshpejtuar procesin e çështjes në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes planit të njohur si franko-gjerman. Këtë gjë e ka konfirmuar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka thënë se atyre do t'u bashkohet edhe emisari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. "Po, besoj që në pjesën e parë të janarit do të vijnë në Kosovë. Besoj se në takim do t'u bashkohet edhe emisari i ShBA-së", ka deklaruar ajo për mediet në Kosovë. Qëllimi i vizitës së tyre, ka konfirmuar presidentja, është shtimi i dialogut dhe arritja e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë dhjetorit të 2022-s pati thënë se Kosova nuk e ka refuzuar planin franko-gjerman. "Unë e kam vlerësuar këtë propozim si hap në drejtimin e duhur. Korniza e përgjithshme e marrëveshjes ka qenë pika e parë më 18 gusht në Bruksel. Deri më tani kemi pasur dialog për proces, por jo për marrëveshje. Më 9 shtator, ende pa u bërë një muaj, patën ardhur në zyrën time këtu e më pas shkuan në Beograd këshilltarët e lartë të presidentit Macron dhe kancelarit gjerman…", ka deklaruar Kurti.

Propozimet e këtij plani dhe përmbledhjen e modeleve, Kurti i ka quajtur si "bazë e mirë", megjithatë ka shtuar se ka edhe vërejtje. "Pra ata kanë sjellë përmbledhje të ideve, të modeleve të cilat unë nuk i kam refuzuar, por janë bazë e mirë. Unë i kam vërejtjet e mia, por nuk e kam kundërshtuar atë propozim. Por në Beograd i thanë jo pas mbledhjes së Këshillit të Sigurisë së tyre", është shprehur Kurti.

Ky propozim, i njohur edhe si plani franko-gjerman, mësohet se u është dhënë palëve qysh në fund të verës së vitit të kaluar. Ai ka mbështetjen e Francës, të Gjermanisë dhe të Shteteve të Bashkuara.

Në dokument nuk përmendet njohja e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë apo anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të cilat gjëra insistojnë publikisht zyrtarët e Kosovës, por theksohet mbështetja që palët duhet t'i japin njëra-tjetrës në procesin e integrimeve evropiane.

Nga Serbia, po ashtu, kërkohet që të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Ish-zëvendëskryeministrja dhe ish-kryenegociatorja e dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka thënë në një shkrim autorial për gazetën "Epoka e re" se një marrëveshje finale paqësore në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin amerikan dhe evropian, duhet të arrihet sa më shpejt në mënyrë që të vendoset një paqe e qëndrueshme në Ballkan. Sipas saj, plani franko-gjerman nuk e ka njohjen reciproke mes dy shteteve Kosovës dhe Serbisë, prandaj nuk duhet të pranohet. "Një marrëveshje e pranueshme duhet ta përfshijë njohjen reciproke direkte, de jure mes dyja shteteve, që përcakton fajësinë e Serbisë për luftën gjenocidale në Kosovë dhe obligimin për dëmshpërblimet për luftën ndaj Kosovës sipas modelit të Traktatit të paqes mes Francës dhe Gjermanisë, e njohur si Traktati i Elysee-s, sipas të cilit, Gjermania ka marrë përsipër fajësinë dhe dëmshpërblimet e luftës ndaj Francës. Një marrëveshje e tillë mund të sjellë një paqe të qëndrueshme në Ballkan dhe midis dy shteteve. Kjo është e vetmja rrugë për ta hapur kapitullin e paqes pas luftës dhe gjenocidit serb në Kosovë. Në këtë mënyrë mbyllet kapitulli i armiqësisë në mes të Kosovës dhe Serbisë, madje dhe më gjerë mes shqiptarëve dhe serbëve", ka deklaruar Tahiri.

## Plani franko-gjerman sipas Euroactivit?

**Neni 1:** Kosova dhe Serbia duhet të zhvillojnë raporte normale, të mira, fqinjësore me njëra-tjetrën, bazuar në të drejta të barabarta.

**Neni 2:** Kosova dhe Serbia do të udhëhiqen nga aspiratat e përbashkëta për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

**Neni 3:** Konform Marrëveshjeve të Stabilizim-Asocimit (MSA) të nënshkruara nga të dyja palët, Kosova dhe Serbia duhet të zgjidhin çdo mosmarrëveshje mes asaj kohe vetëm përmes mjeteve paqësore dhe duhet të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës. Ato riafirmojnë paprekshmërinë tani dhe në të ardhmen të kufirit ekzistues mes tyre dhe zotohen për respektimin e plotë të

# Në muajin mars pritet të fillojë gjykimi ndaj Thaçit e të tjerëve

**Prishtinë, 4 janar -** Ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, tashmë i kanë mbushur dy vjet që po mbahen në paraburgim nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Procesi ndaj ish-krerëve të UÇK-së pritet të jetë një gjykim maratonik. Megjithatë, OVLUÇK-ja nuk pret proces të shpejtë e transparent ndaj ish-krerëve të UÇK-së në ballafaqim me drejtësinë.

Shqiptimi 26 vjet burg për ish-eprorin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sali Mustafën, ishte aktgjykimi i fundit i 16 dhjetorit 2022 i shpallur nga Dhomat e Specializuara.

Para dënimit të Mustafës kjo gjykatë ka dënuar edhe ish-krerët e OVLUÇK-së, Hysni Gucati e Nasim Haradinaj.

Megjithatë, një gjykim tjetër maratonik pritet të fillojë në muajin mars.

Gjykimi i ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, pritet të ketë një përballje të fortë e të gjatë me prokurorë e gjykatës të Dhomave të Specializuara.

Për këtë, avokati i licencuar në këtë gjykatë, Artan Qerkini, thotë se ndonëse janë 46 mijë faqe dokumente e më shumë se 40 dëshmitarë, gjykimi ka gjasa të fillojë më shpejt. "Po shpresoj se kjo zvarritje e procedurave do të kompensohet me një efikasitet të procedurës nga ana e trupit gjykues", thotë avokat Qerkini për "RTK-në". Ai ka theksuar se në këtë drejtim trupi gjykues veçse ka nxjerrë një draft urdhër të procedurave dhe i ka dhënë mundësi mbrojtjes.

Në Institutin e Kosovës për Drejtësi thonë se më së largu në muajin prill pritet të fillohet me deklaratat hyrëse. Ndërkohë, në verën e vitit të ardhshëm, sipas Ehat Miftarajt, pritet të fillojë gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve.

"Do të jetë një gjykim maratonik për faktin që kemi qindra dëshmitarë të ftuar të prokurorisë, e sigurisht se do të kemi dëshmitarë nga ana e mbrojtjes dhe se çdo dëshmitar që merret, mund të zgjasë dy vjet apo më shumë", ka deklaruar Miftaraj.

Ndërkohë, në Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së kanë theksuar se nuk presin proces të shpejtë e transparent, duke e quajtur Gjykatën Speciale gjykatë politike. "Procesi do të jetë i njëjtë me stërzgjatje të procedurave, jo barabarësi mes palëve, të cilët edhe në proceset e mëhershme prokuroria i ka vonuar dokumentet. Nuk presim proces të rregullt", ka thënë Faton Klinaku, ushtrues i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së.

Ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, tashmë i kanë mbushur dy vjet që mbahen në paraburgim nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.



integritetit territorial të njëra-tjetrës.

**Neni 4:** Kosova dhe Serbia vazhdojnë me supozimin se asnjëra nga të dyja palët nuk mund të përfaqësojnë palën tjetër në sferën ndërkombëtare, apo të veprojnë në emër të tyre.

**Neni 5:** Kosova dhe Serbia duhet të promovojnë raporte paqësore në Ballkanin Perëndimor dhe të kontribuojnë në sigurinë rajonale dhe bashkëpunimit në Evropë.

**Neni 6:** Kosova dhe Serbia vazhdojnë në respektimin e ndërsjellë të juridiksionit të njëra-tjetrës.

**Neni 7:** Kosova dhe Serbia shprehin gatishmërinë e tyre për të rregulluar çështjet praktike dhe ato humanitare në procesin e normalizimit të raporteve të tyre. Ato duhet të lidhin marrëveshje me qëllim që të zhvillojnë dhe promovojnë në bazë të Traktatit të prezantuar për bashkëpunimin që do të përfitonin të dyja palët në fushën e ekonomisë, shkencës dhe teknologjisë, transportit, raporteve gjyqësore, postës dhe telekomunikacionit, shëndetësisë, kulturës, sportit, mbrojtjes së mjedisit dhe në fusha të tjera. Për detajet është rënë dakord në Protokollin Suplementar.

Neni 8: Kosova dhe Serbia duhet të kenë misione të përhershme. Ato duhet të vendosen në selitë e qeverive përkatëse. Çështjet praktike sa i përket themelimit të misioneve duhet të trajtohen ndaras.

**Neni 9:** Kosova dhe Serbia pajtohen se Traktati i tanishëm nuk duhet të ndikojë te traktatet dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare dhe në marrëveshjet që tashmë janë arritur ose që lidhen me to.

## Aksion kundër taksive ilegale që qarkullojnë në relacionet Podujevë - Prishtinë

**Podujevë, 4 janar** - Drejtoria e Inspeksionit në Podujevë, me asistim edhe të policisë, është duke zhvilluar aksion kundër taksive ilegale që qarkullojnë në relacionet Podujevë - Prishtinë.
Gjatë kësaj kohe, kur fluksi i mërgimtarëve në trafik është i madh, taksitë ilegale me vendparkimet e tyre po shkaktojnë telashe të shumta në mbarëvajtjen e komunikacionit. Ata, gjithashtu, po paraqesin rrezik potencial edhe për udhëtarët që i përdorin për qarkullim.
Drejtoria e Inspeksionit ka njoftuar se do të vazhdojë edhe në ditët në vijim aksionet e tilla edhe në pika të tjera me qëllim të zhbllokimit të rrugëve, trotuareve dhe respektimit të rregullave të qarkullimit.




# Ngjarje tragjike në Prizren, vritet një shtetas i Shqipërisë, ndalohen për 48 orë gjashtë të dyshuar

**Prizren, 4 janar** - Mëngjesin e së martës në Prizren, pas një përleshje të nisur në lokalin e natës "Kobra City", nga të shtënat me armë zjarri një person mbeti i vrarë, kurse një tjetër është plagosur, të dy shtetas të Shqipërisë. Sipas prokurorisë, konflikti nisi lidhur me pagesën e faturës së shpenzimeve.
Për ngjarjen tragjike kanë dhënë detaje policia, prokuroria dhe avokati i të dyshuarit për vrasjen.
Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Admir Shala, i ka thënë "Telegrafit" se dyshohet se ngjarja tragjike ka ndodhur pas një konflikti në lokalin "Kobra City" me disa shtetas të Shqipërisë lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve.
"Sot në orën 04:10 policia ka marrë informatë se ka pasur të shtëna në afërsi të lokalit 'Kobra City', në dalje të Prizrenit, rruga Prizren - Kukës. Dyshohet se ngjarja tragjike ka ndodhur pas një konflikti në lokalin 'Kobra City' me disa shtetas të Shqipërisë lidhur me pagesën e faturës së shërbimeve", ka thënë Shala.




Ai ka thënë se në momentin që shtetasit V. C., R. Sh dhe A. B. po largoheshin me automjetin e tyre të markës "Audi", dyshohet së shtetasi D. H. (Dibran Hoxha) ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit të tyre. "Si pasojë e të shtënave me armë zjarri, 31-vjeçari me inicialet V. C. dhe R. Sh., 27 vjeç, të dy nga Kukësi, janë plagosur. Si pasojë e plagëve shtetasi V. C. ka vdekur, ndërsa shtetasi R. Sh. ka pësuar lëndime trupore dhe është jashtë rrezikut për jetë", ka thënë ai.
Lajmi fillimisht është dhënë nga Policia e Shtetit në Shqipëri. Në njoftimin për medie u tha se viktima që përfundoi me fatalitet është 31-vjeçari me inicialet V. C., ndërsa i plagosuri është R. Sh., 27 vjeç, të dy nga Kukësi. "Në Morinë, rreth orës 04:25, të mëngjesit, kanë hyrë për në drejtim të spitalit rajonal të Kukësit, shtetasit V. C., 31 vjeç, dhe R. Sh., 27 vjeç, që transportoheshin me automjet nga shtetasi A . B., të tre nga Kukësi, ku shtetasit V. C dhe R. Sh. ishin të plagosur me armë zjarri në Prizren të Kosovës. Si pasojë e plagëve të marra, shtetasi V. C. ka ndërruar jetë gjatë rrugës, ndërsa shtetasi R. Sh. ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve", thuhej në njoftim.
Për vrasjen dhe plagosjen e një personi në Prizren gjashtë persona të dyshuar janë intervistuar në Stacionin Policor në Prizren dhe me vendim të prokurorit janë ndaluar për 48 orë në ndalim policor.

# Lladrovcit i dhurohet libri "Në tokën amë, Kosovë"



**Drenas, 4 janar** - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të mërkurën ka pritur përfaqësuesin e Bankës Ekonomike, njësia në Drenas, Labinot Tahiraj, nga i cili ka marrë librin "Në tokën amë, Kosovë".
Kryetari Lladrovci e ka përgëzuar Bankën Ekonomike për publikimin e këtij libri, i cili pasqyron tokën e Kosovës me bukuritë natyrore që ka vendi ynë dhe trashëgimia kulturore, ku në këtë libër pasqyrohen bukuritë natyrore e të trashëgimisë të Drenasit.
Përfaqësuesi i Bankës Ekonomike, njësia në Drenas, Labinot Tahiraj, ka uruar kryetarin Lladrovci për vitin 2023.
Libri ka mbi 400 faqe, rreth 500 fotografi nga të gjitha rajonet e Kosovës, ku shpalosen bukuritë përrallore të vendit tonë, së bashku me tregimet e thurura për to nëpër histori. Drenasi përfaqësohet me bukuritë natyrore të shkrepura nga fotografi Albert Sinani.

## Nënshkruhet kontrata për ndërtimin e objektit të ri të Fakultetit të Shkencave Matematikore dhe atij Ekonomik

**Prishtinë, 4 janar** - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se së bashku me rektorin e Universitetit të Prishtinës, Qerim Qerimi, kanë nënshkruar kontratën e ndarjes së lokacionit për ndërtimin e objektit të ri të Fakultetit të Shkencave Matematikore-Natyrore dhe Fakultetit Ekonomik. "Kënaqësi të takohem me rektorin e ri të Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Qerim Qerimi, me të cilin nënshkruam kontratën e ndarjes së lokacionit për ndërtimin e objektit të ri të Fakultetit të Shkencave Matematikore - Natyrore dhe Fakultetit Ekonomik", ka shkruar Rama në "Facebook".



# Ja si mund të ndryshohet gjendja në këtë vend



Shkruan: Milazim KRASNIQI

Kosova sot është një vend bukur shumë i degraduar nga varfëria e madhe e një pjese së banorëve, të cilët po provojnë të ikin nga sytë këmbët. Kosova sot është një vend i degraduar nga papunësia enorme, nga mosrespektimi i ligjit, nga dëmtimi i ambientit dhe nga mungesa e shpresës për të ardhmen. Përshkrimi i këtyre niveleve të degradimit mund të bëhet gjerësisht dhe në detaje por ai nuk e zgjidh problemin, nuk jep përgjigje në pyetjen se a ka zgjidhje për problemet e saj. Prandaj, kësaj radhe në vend të përshkrimit, do të përpiqem të jap një version se si mund të fillojë zgjidhja e këtyre problemeve.

1. Qeveria e vendit duhet që krahas shumëfishimit të subvencioneve për tokën e punuar dhe për mbajtjen e bagëtive, të fillojë një proces të menjëhershëm të trajnimit të bujqve të rinj anekënd vendit. Këto trajnime mund të mbahen nga ekspertë vendas, por edhe nga ekspertë që do të vinin nga vende të rajonit, me përparësi nga Shqipëria e nga Maqedonia, edhe për shkak të disa përvojave të reja që po aplikohen në këto vende e edhe për arsye se nuk ka barriera gjuhësore. Ky proces trajnimi e shkollimi do të duhej të shoqërohej edhe nga një radiografi e tokave bujqësore, duke u dhënë bujqve informata për cilësinë e tokës përkatësisht për pemët, perimet ose drithërat që u përshtaten më shumë cilësive të tokës bujqësore. Me këtë përshtatje të planifikimit bujqësor në pajtim me cilësinë e tokave, do të mund të kalohej në konceptin e bujqësisë si biznes, i cili do ta rriste prodhimin dhe do të motivonte ngritjen e mirëfilltë të industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Ngritja e kësaj industrie do të duhej të bëhej duke u dhënë përparësi e lehtësira të shumta bashkatdhetarëve tanë që duan të investojnë e të kthejnë kapitalin e tyre në Kosovë.

2. Ngritja e shkollave të mesme bujqësore dhe forcimi i Fakultetit të Bujqësisë, duke rritur numrin e kuadrit e numrin e studentëve dhe rritjen e buxhetit të tij, do të ndihmonin në ndryshimin e shpejtë të gjendjes së mjerueshme në bujqësinë dhe në blegtorinë e vendit tonë. Të rinjtë e talentuar duhet të inkurajohen që të shkojnë në shkolla bujqësore dhe të studiojnë në Fakultetin e Bujqësisë, sepse është njëra nga degët kryesore të ekonomisë, që siguron punësim dhe zhvillim më të shpejtë të vendit. (Qoftë dhe vetëm mbledhja e bimëve dhe frutave mjekuese, nëse do të krijohej lidhja me industrinë farmaceutike, do të ndikonte në punësim e lërë më i gjithë spektri i prodhimtarisë bujqësore e blegtorale dhe përpunimit të saj.)

3. Universitetet publike duhet të departizohen e të depolitizohen tërësisht dhe të lihen që ta ushtrojnë autonominë e vet, me çka do ta rrisnin edhe cilësinë e studimeve e edhe dinjitetin e studiuesve që punojnë në to. Universitetet me autonomi të plotë, do të orientonin hulumtimet e veta drejt problemeve akute që ka ekonomia dhe shoqëria, me çka do ta rrisnin partneritetin me kompani dhe korporata të interesuara për hulumtimin e tregut dhe problematikave me të cilat ato janë të preokupuara. Shkurt e shqip, me rritjen e dukshme të cilësisë së studimeve dhe të hulumtimeve në universitete, përmirësohen ekonomia dhe demokracia në vend.

4. Kthimi i trurit mund të jetë një promotor i zhvillimit të vendit tonë. Janë me mijëra djem dhe vajza të familjeve të bashkatdhetarëve tanë në mërgata, që kanë kryer universitete anekënd Evropës dhe SHBA-ve. Ata janë shkolluar me paratë e familjeve të veta, ndërsa Kosova e ka rastin që shumë prej tyre, të atyre që duan të vijnë, t'i merr si kuadro të gatshme. Kthimi i tyre do ta ngrehte cilësinë e punës dhe etikën e punës dhe do të motivonte për punë më të përgjegjshme edhe vendasit. Përzgjedhja mund të bëhet sipas nevojave imediate që ka ekonomia dhe shoqëria, me theks te ekspertët e bujqësisë, inxhinierisë, matematikës, shkencave kompjuterike. Por, kjo bëhet vetëm me vullnet dhe me projekt. Tash për tash të dyja mungojnë.

5. Turizmi dimëror dhe i fshatit kanë një perspektivë të shkëlqyeshme në vendin tonë. Nëse do të eliminoheshin barrierat administrative dhe korrupsioni, do të mund të rritej interesimi i investitorëve për këtë fushë. Terrenet për skijim janë të mrekullueshme në shumë zona të vendit, prandaj ato mund të bëhen atraksion i vërtetë turistik. Edhe disa nga fshatrat e vendit tonë, mund të paraqesin kuriozitet për turistë. Ndërsa zhvillimi i kësaj dege të turizmit, në mënyrë direkte do të ndikonte edhe në zhvillimin e blegtorisë e të bujqësisë. Por, në Kosovë duhet të hapen edhe shkolla të mirëfillta për kamerier e për të studiuar turizmin, sepse shërbimet që ofrohen sot për sot në hotelet dhe në restorantet e vendit tonë, janë jashtë standardeve.

Konkluzioni ynë është se fshati i ndryshuar dhe universitetet e ndryshuara, mund ta ndryshojnë edhe politikën në këtë vend. Meqë në Kosovë nuk ka as elita sindikale, as elita fetare e as ushtarake, që do të mund të kishin ndonjë ndikim në ndryshimin e gjendjes, pra, mbeten vetëm fshati dhe universitetet, që ta ushtrojnë këtë mision. Është mision i vështirë meqë si ndryshimi i fshatit ashtu edhe i universiteteve, janë në dorë të politikës. Por, ia vlen të provohet që të dilet disi nga ky rreth. Si ndryshimi pozitiv i gjendjes në shoqëri, si kërkimi i fatit më të mirë të gjithsecilit, duhet të kërkohen e të realizohen këtu, në vendin tonë, për të cilin është bërë një rezistencë sublime çlirimtare nga një popull i tërë. Nuk mund të hiqet dorë nga e ardhmja e tij, tash kur ajo e ardhme është më lehtë e realizueshme. Duhet vetëm më shumë dije e më shumë vullnet.

# Një vit luftë me inflacionin: Cilat janë parashikimet për 2023-shin?



Prishtinë, 4 janar - Rritje dyshifrore e inflacionit që varfëroi shportën e konsumatorit dhe ngadalësoi aktivitetin ekonomik. Ky trend karakterizoi Kosovën pothuajse gjatë gjithë vitit 2022, por që pritet të stabilizohet apo të bjerë në vitin 2023, sipas institucioneve financiare.

Disa qytetarë të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë" në Prishtinë thonë se situata e krijuar me rritjen e çmimeve i detyroi ata të heqin dorë nga disa produkte, ose t'i sigurojnë me vështirësi. "Mishi është harruar, krejt rrallë e hiç", thotë Feride Vokrri. Rritje çmimesh në disa raste mbi 100 % kanë pësuar shumica e produkteve dhe shërbimeve nga mishi, mielli, vaji deri te materialet ndërtimore, rryma, nafta. "Një litër vaj ulliri 8 euro, për të tjerat nuk e di çfarë të them. Të gjitha shtrenjtë, të gjitha", thotë Mihrije Osmani.

Për Namik Canhasin rritja e çmimeve është "jonormale".

Patriot Maqastena, i cili punon tregtar në Tregun e Gjelbër në Prishtinë, thotë se shitjet kanë rënë. "Blerës ka më pak, disa çmime janë rritur pak më shumë, disa artikuj, jo të gjithë", thotë ai.

Si gjetkë në botë, rritja e çmimeve ka nisur nga fundi i vitit 2021 si pasojë e çrregullimeve në zinxhirin e furnizimeve që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit.

Çmimet kanë marrë hov më të madh kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në fund të shkurtit.

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se vendi do ta përmbyllë vitin me normë mesatare të inflacionit 12 për qind.

Paga mesatare e punonjësve, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ishte rreth 480 euro.

Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP, me seli në Prishtinë, publikoi në muajin nëntor një raport për ndikimin e inflacionit në ekonomitë familjare.

Blendi Hasaj, drejtor ekzekutiv i këtij instituti, ka treguar se nga muaji mars norma e inflacionit në Kosovë ka qenë dyshifrore. "Ndërkaq në muajin nëntor kjo normë ka arritur vlerën 11.6 për qind. Tash nëse e krahasojmë këtë me të ardhurat mujore të një familjeje tipike prej 400 eurosh, atëherë rritja e çmimeve në vitin që lamë pas ka ndikuar që të pjesa e ushqimeve të rritet kostoja mujore prej 28 eurosh për një familje. Te shpenzimet që bëhen për transport janë rritur 6 euro, krahasuar me vitin e kaluar (2021)", ka thënë ai, duke shtuar se të kategoritë e tjera janë rritur shpenzimet mujore rreth 15 për qind si, për shembull, te telekomunikimi.

Në përpjekje për ta zbutur ndikimin e inflacionit, Qeveria e Kosovës miratoi në muajin shtator një pako në vlerë prej 150 milionë eurosh. Prej saj përfituan një numër qytetarësh, kryesisht familje me asistencë sociale dhe pensionistë.

Zyrtarë të Ministrisë së Financave të Kosovës nuk iu përgjigjën kërkesës së REL-it për të biseduar për këtë çështje. Sipas Institutit GAP, autoritetet është dashur të marrin masa që do ta mbështesnin edhe rritjen e prodhimit të brendshëm meqë inflacioni në Kosovë është në masë të madhe i importuar.

Kosova importon shumicën e produkteve nga shtetet fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian.

Nga Oda Ekonomike e Kosovës thonë, po ashtu, se masat e ndërmarra nga autoritetet nuk ishin të mjaftueshme.

Lulzim Rafuna, kryetar i kësaj ode, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Qeveria e Kosovës nuk ka vepruar sipas ligjeve në fuqi, përkatësisht nuk i ka rritur pagat në sektorin publik në përputhje me rritjen ekonomike.

Në sektorin publik në Kosovë janë të punësuar mbi 80 000 persona me pagë mesatare bruto rreth 620 euro.

Vlerësimet e Bankës Qendrore të Kosovës për rritjen ekonomike në vitin 2022 janë më negative.

Nga 10 për qind sa ka qenë vitin e kaluar, këtë vit nuk pritet të kalojë 4 për qind.

Hasaj, nga Instituti GAP, thotë se inflacioni ndikon në aktivitetin ekonomik, sidomos në një vend si Kosova që nuk ka kapacitete të mëdha prodhuese.

Për vitin 2023 Banka Qendrore e Kosovës parasheh rënie të inflacionit.

Guvernatori i këtij institucioni, Fehmi Mehmeti, jep më shumë hollësi për "Radion Evropa e Lirë": "Pritjet tona janë që në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 të kemi ulje të inflacionit deri në 6 për qind dhe kjo në masë të madhe do ta ndikojë aftësinë paguese të qytetarëve, që më pastaj do të ndikojë në rritjen e konsumit si komponent kryesor i rritjes ekonomike në vend".

Edhe ekonomistët e huaj, që i citojnë disa media ndërkombëtare, presin që inflacioni të bjerë në vitin 2023.

Një arsye për këtë optimizëm është stabilizimi i zinxhirit të furnizimeve, ndonëse është vështirë të parashikohet me siguri se çfarë do të ndodhë në skenën gjeopolitike.

## Nga 1 janari stikersat me ngjyrë të gjelbër

Prishtinë, 1 janar - Nga 1 janari i këtij viti stikersat e lëshuara nga Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve në gjithë vendin do ta mbajnë ngjyrën e gjelbër, pra nuk do të jenë me ngjyrë të njëjtë siç kanë qenë edhe vitin e kaluar.

Ndryshimi i ngjyrës ka për qëllim të vetëm lehtësimin e punës së Policisë së Kosovës, pra për t'i dalluar nga distanca automjetet që dalin në komunikacion pa një policë të sigurimit. "Përndryshe implementimi i stikersave ka dhënë rezultate të dukshme duke ulur numrin e automjeteve të paregjistruara në vendin tonë. Ky projekt mbulohet nga kompanitë e sigurimit që janë biznese 100 për qind private. Pra, qytetarët nuk paguajnë asnjë cent për stikersin që e vendosin në xhama të automjeteve të tyre", ka njoftuar Byroja Kosovare e Sigurimit.



# Kriza në zemrën industriale të Gjermanisë



Rruga gjarpëruese nëpër fshatrat gjermane nga Shtutgarti në qytetin e vogël të Mulfingen të krijon një ide, se ky rajon jugperëndimor është qendra e disa kompanive që janë liderë të tregut global në fushën e veprimtarisë së vet.

Por pjesa në veri-lindje të Baden-Württemberg krenohet me disa firma të specializuara që përbëjnë Mittelstand-in, bazën e kompanive inxhinierike të vogla dhe të mesme, shtylla kurrizore e ekonomisë gjermane, që e kanë zili në mbarë botën.

Prodhuesja i ventilatorëve ebm-papst ka selinë në Mulfingen – një qytet me një popullsi prej rreth 3,600 banorësh. Produktet e saj gjenden në të gjithë botën në makina, pajisje shtëpiake dhe qendra të dhënash.

Kriza energjetike, mungesa e fuqisë punëtore dhe ndërprerja e shkaktuar nga pandemia në zinxhirët e furnizimit po akumulon presion mbi këto biznese, të cilat tradicionalisht janë familjare dhe nuk kanë xhepa të thellë, si gjigantët e korporatave gjermane.

Me Gjermaninë e përgatitur për recesion, mënyra se si reagon kjo qendër industriale do të ndihmojë në formimin jo vetëm të së ardhmes së vendit, por edhe të eurozonës në tërësi. GDP-ja e Gjermanisë parashikohet të jetë e treta më e dobët në vendet e G20 (-0.3%) këtë vit, sipas Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, pas Rusisë dhe Britanisë. Prodhimi përbën rreth një të pestën e ekonomisë së Gjermanisë, më shumë se dyfishi i 9%-shit të Britanisë dhe Francës dhe shumë përpara 15%-shit të Italisë.

Rreth 4,000 persona punojnë për ebm-bapst në Mulfingen, punëdhënësi më i madh industrial në rajon. E themeluar në vitin 1963 nga Gerhard Sturm, kompania, e cila e quan veten një "kampione e fshehur", mbetet në pronësi të familjes, por është drejtuar vitin e fundit nga shefi ekzekutiv, Klaus Geißdörfer. Nën udhëheqjen e tij, ajo vendosi t'i japë fund prodhimit të ventilatorëve për makina dhe e ka zhvendosur stafin në propdhimin e teknologjive të reja, të tilla si ventilatorët për pompat e nxehtësisë dhe për ftohjen e qendrave të dhënave.

"Ne menduam se është më mirë të fokusohemi në gjërat ku jemi vërtet më të mirët në botë," thotë Geißdörfer. "Vendosëm të rrisim ndjeshëm kapacitetet tona, të cilat do t'i forcojmë vitin e ardhshëm, sepse për momentin nuk jemi në gjendje të ndjekim kërkesën."

Pavarësisht përfitimit nga lulëzimi i shitjeve në ventilatorët për teknologjitë e rinovueshme, vitet e fundit nuk kanë qenë të lehta për ebm-papst. Bllokimet e shkaktuara nga Covid në Kinë dhe ndërprerja e zinxhirit të furnizimit i ndaluan herë pas here linjat e saj të prodhimit gjerman, gjë që sipas Geißdörfer "nuk ka kuptim". Si rezultat, kompania ka punuar për të siguruar më shumë pjesë prodhimi në vend, si dhe në SHBA dhe Kinë.

Pak më poshtë ndodhet selia e prodhuesit pothuajse 80-vjeçar të vidhave dhe fiksuesve Würth, pranë Bürkert, një prodhues i sistemeve të matjes dhe kontrollit për lëngjet dhe gazrat. "Rajoni ka shumë kompani lidere të tregut botëror", thotë Donata Lell, e cila drejton një bujtinë dhe restorant vendas. Ajo beson se baza industriale rrit fuqinë shpenzuese të klientëve të saj: "Njerëzit këtu fitojnë më shumë para".

Geißdörfer, i cili vjen nga Bavaria fqinje, është i bindur se komuniteti i vogël i Mulfingenit është një vend i mirë për të drejtuar një biznes prodhimi. "Kemi njerëz të zgjuar këtu. Më pëlqen shpirti që kanë njerëzit këtu, ata janë shumë entuziastë", tha ai.

Por a ka kompania mjaftueshëm nga ata njerëz, sa të plotësojë kërkesën në rritje? Pavarësisht pozitivitetit të Geißdörfer, ebm-papst ka vështirësi në gjetjen e personelit me aftësitë e duhura, si dhe probleme në marrjen e komponentëve, të tillë si gjysmëpërçuesit. Është përpjekur për të zgjidhur mungesën e punëtorëve duke ofruar punë në distancë personelit në role administrative, plus udhëtime falas me autobus për në punë për punonjësit që jetojnë brenda një rrezeje 40 km (25 milje), një përfitim i shfrytëzuar nga rreth 1500 njerëz.

Mes presioneve të kostove dhe çmimeve më të larta të kërkuara nga furnitorët e saj, pjesëtarë të stafit thonë se po luftojnë me krizën e kostos së jetesës. Ata i kanë ngritur shqetësimet për vështirësitë e tyre personale financiare drejtpërdrejt tek Geißdörfer.

"Kisha njerëz që vinin tek unë dhe më thoshin 'Nuk mund të blej më dhurata për Krishtlindje për fëmijët e mi', thotë ai. "Flas me njerëzit dhe ata thonë: "Unë nuk mund të përballoj më pushimet".

Gjatë verës, kompania i pagoi stafit një shtesë prej 2,500 € në pagesa për mbulim të kostove të jetesës, të bëra në pesë këste mujore prej 500€, nga tetori e në vazhdim.

"Ne u qëndrojmë pranë njerëzve dhe i mbështesim ata në kohë të vështira," tha Geißdörferfer, duke e përshkruar këtë si një pikë të fortë të Mittelstand. "Kjo është gjëja pozitive me këtë lloj strukture biznesi familjar që kemi në Gjermani. Shoh edhe kompani të tjera që bëjnë gjëra të ngjashme."

Megjithatë, kjo mund të mos mjaftojë. Sindikata e IG Metall, punonjësve të çelikut, më e madhja në vend, përfaqëson punëtorët në vendet e tjera ku vepron ebm-papst në Gjermani, por jo në qendrën e saj kryesore në Mulfingen, si rezultat i një marrëveshjeje historike. Po punojmë për të futur këmbën edhe aty, thotë Uwe Bauer, përfaqësuesi i IG Metall për rajonin Schwäbisch Hall.

Bauer tha se sindikata kishte rekrutuar disa qindra anëtarë në Mulfingen muajt e fundit, teksa punëtorët kuptuan se punësimi i plotë në vend kishte krijuar "një treg punëmarrësish". "Bizneset duhet të rimendojnë se çfarë të bëjnë për punëtorët e kualifikuar," thotë ai.

"Ne kemi shumë kërkesa se cilat kompani janë të detyruara me marrëveshje kolektive të pagave. Pagat luajnë një rol, por po ashtu edhe orari i rregullt i punës."

Oferta e pagave e ebm-papst në nivel kombëtar është gjerësisht në përputhje me marrëveshjen kolektive të arritur midis IG Metall dhe punëdhënësve në Baden-Württemberg në fund të nëntorit, megjithëse punëtorët në Mulfingen nuk i nënshtrohen kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja e pagave, e cila përcakton standardin për rritjen e pagave për pothuajse 4 milionë punëtorë të sektorit të metaleve dhe elektrik në të gjithë Gjermaninë, rrit pagat e punëtorëve me 5.2% nga qershori dhe 3.3% nga maji 2024. Ata gjithashtu do të marrin një "bonus inflacioni" prej 3,000 €, siç e quan sindikata.

Marrëveshja është bujare për nga standardet historike, por tërhoqi disa kritika për zbatimin nën normën e inflacionit prej 10% në nëntor.

Sigurimi i pjesëve mbetet një sfidë duke pasur parasysh mungesën globale të çipave gjysmëpërçues që nga fillimi i pandemisë. Në garën për të marrë këto komponentë jetik, kompanitë e Mittelstand e gjejnë veten të paafta për të konkurruar financiarisht me prodhuesit më të mëdhenj gjermanë, veçanërisht prodhuesit e makinave.

"Si kompani mund të rritemi më shpejt nëse mund të marrim më shumë gjysmëpërçues," thotë Geißdörfer. "Në një farë mënyre, ne konkurrojmë. Por industria po konkurron me industrinë e automobilave, industrinë diellore dhe industrinë e energjisë së rinovueshme, dhe ne të gjithë kemi nevojë për të njëjtët lloj materialesh elektronike."

Qeveria duhet të bëjë më shumë për të mbështetur rrjetin jetik të kompanive të vogla dhe të mesme, thotë ai, veçanërisht me rritjen e kostove të energjisë, të cilat ai beson se po i bëjnë firmat evropiane globalisht jo konkurruese në krahasim me rivalet aziatike ose amerikane. Rënia së fundi e çmimeve të energjisë ka ofruar vetëm një fije shprese.

"Unë kam vërtet shqetësime për kompanitë më të vogla gjermane dhe ato të mesme që varen shumë nga energjia. Ato kanë probleme reale për të punuar për t'u përballur me ato rritje të mëdha të energjisë."

Ndërsa mirëpret mbështetjen e qeverisë me faturat e energjisë, Geißdörfer dhe bosët e tjerë të Mittelstand kanë frikë se qeveria nuk ka një strategji të qartë industriale, veçanërisht ndërkohë që e largon vendin nga gazi i lirë rus. Vendimi i qeverisë së Angela Merkelit për të fikur termocentralet bërthamore pas katastrofës së Fukushimës në Japoni në vitin 2011, e ka lënë atë të ekspozuar ndaj gazit nga Kremlini.

"Në Gjermani kemi nevojë të rishpikim veten", thotë Geißdörfer, duke pranuar sfidat gjeopolitike, duke përfshirë tranzicionin energjetik dhe Brexit. "Ne jemi ende mjaft të fortë dhe kemi para të mjaftueshme dhe mund ta përballojmë, por duhet ta bëjmë këtë shpejt, të mendojmë se si të kemi një ekonomi të qëndrueshme. Por jemi një minutë para mesnate."

/ *The Guardian – Bota.al*

# Ekonomistët paralajmërojnë një tjetër vit të trazuar për tregjet




Investitorët duhet të përgatiten për një tjetër vit të trazuar në tregjet financiare, kanë paralajmëruar ekonomistët, teksa bankat qendrore luftojnë inflacionin, Kina rihap ekonominë pas kufizimeve të Covid dhe lufta e Ukrainës e shtyn ekonominë globale drejt recesionit.

Gjysma e parë e vitit të ri ka të ngjarë të jetë me luhatje, sipas parashikimeve të Wall Street, pasi vitin që kaloi, tregjet globale pësuan rënien e tyre më të madhe që nga kriza financiare e vitit 2008.

Por S&P 500 i SHBA-së gjithësesi pritet të përfundojë vitin 2023 pak më lart se sa e nisi. Objektivi mesatar i 22 strategëve të pyetur nga Bloomberg është që ta mbyllë vitin 2023 me 4,078 pikë – rreth 6% më lartë se në vitin 2022.

Ekonomistët po kërkojnë që Rezerva Federale e SHBA-së të ngadalësojë rritjen e normave të interesit këtë vit, teksa perspektiva për ekonominë e Amerikës përkeqësohet. Inflacioni në SHBA ka rënë nga kulmi që arriti verën e kaluar, ndërsa rritja e normave të interesit në vitin 2022 ka tkurrur tregun e banesave.

"Ne besojmë se një periudhë e rritjes është e pashmangshme dhe rreziqet e recesionit janë të larta pasi efektet e vonuara të një politike të shtrënguar monetare ndjehen në ekonomi," tha Brian Rose, ekonomist i lartë amerikan në UBS Global Wealth Management.

Michael Antonelli, drejtor menaxhimi dhe strateg i tregut në bankën e investimeve Baird, parashikoi se Fed do të "shtypë butonin e pauzës" në shkurt pas një rritjeje të normës së interesit. Ai gjithashtu pret që tregu i aksioneve amerikane të ketë fitime gjatë vitit 2023.

"Tregjet e aksioneve pyesin 'a po përmirësohen, apo po përkeqësohen gjërat?' Unë mendoj se ato do të përmirësohen pak vitin e ardhshëm," tha Antonelli për Yahoo Finance Live. Ai shtoi: "Unë nuk mendoj se po marrim ndonjë fitim të madh, por mendoj se viti i ardhshëm do të jetë disi pozitiv."

Deutsche Bank parashikon rënie ekonomike këtë vit, të cilat do të godasin tregjet financiare. "Ne parashikojmë që tregjet kryesore të aksioneve të bien 25% nga nivelet që ishin kur goditi recesioni në SHBA, por më pas rikuperohen plotësisht deri në fund të vitit 2023, duke supozuar se recesioni zgjat vetëm disa tremujorë," thanë analistët e Deutsche Bank në 2023 World Outlook, në fund të vitit të kaluar.

Një rënie globale mund t'i shtyjë bankat qendrore të anulojnë disa nga masat për rritjen e normave të interesit të zbatuara vitin e kaluar. Nikolaj Schmidt, kryeekonomist ndërkombëtar në firmën e menaxhimit të investimeve T Rowe Price, parashikon se bankat qendrore kryesore do të lehtësojnë politikën monetare në fillim të gjysmës së dytë të 2023.

Schmidt tha: "Ne e shohim që bota po zhytet në një recesion global në vitin 2023. Recesioni do të jetë rezultat i shtrëngimit të jashtëzakonshëm monetar që bankat qendrore kanë zbatuar gjatë 12 muajve të fundit.

Analistët në bankën e investimeve Jefferies parashikojnë një recesion global këtë vit, por presin që Azia mund të shmangë një rënie të drejtpërdrejtë. Rajoni mund të përfitojë nga një ringjallje e turizmit, pasi turistët kinezë do fillojnë t'u rikthehen udhëtimeve.

"Azia mund të shmangë një recesion të drejtpërdrejtë. Në goditjet e kaluara të krizave të dotcom dhe GFC [Kriza e Madhe Financiare], Azia u rimëkëmb shpejt dhe ne presim që ajo të mund të bëjë të njëjtën gjë në 2023 €, thanë ata.

Vendimi i Kinës për të lehtësuar kufizimet e Covid muajin e kaluar mund të lehtësojë tensionet globale të zinxhirit të furnizimit, por gjithashtu mund të çojë në kërkesë më të lartë për mallra dhe energji, duke shtuar presionet e inflacionit.

Banka e Anglisë pritet të rrisë sërish normat e interesit, me normën bankare që parashikohet të arrijë në 4.5% në verë, nga 3.5% që është aktualisht.

FTSE 100 i Britanisë ishte një nga pak indekset kryesore të aksioneve që u rrit gjatë vitit 2022, duke fituar pothuajse 1%. Ipek Ozk-ardeskaya në Swissquote parashikoi se performanca e lartë e FTSE 100 mund të shtrihet edhe gjatë vitit të ri: "Nëse rihapja kineze sjell një tjetër goditje në inflacion për shkak të çmimeve më të larta të energjisë dhe mallrave, FTSE 100 mund të vazhdojë t'u ofrojë një strehë të mirë atyre që janë të gatshëm për të marrë masa mbrojtëse kundër një inflacioni global të shkaktuar nga energjia".

Ekonomia e Rusisë është në recesion. "Pasi ka nisur një luftë brutale, Putini nuk ka rrugëdalje", thonë ekonomistët në bankën Berenberg. / *The Guardian – Bota.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Llapi angazhon trajner të portierëve



PODUJEVË, 4 JANAR - KF Llapi ka njoftuar për marrëveshjen e arritur me ish-trajnerin e portierëve të FC Malisheva, Diamant Kadriolli.
Kadriolli karrierën si portier e ka zhvilluar tek Ulpiana, Feronikeli dhe Drenica, kurse si trajner i portierëve ka punuar tek Ulpiana, Arbëria, së fundmi te Malisheva. Të arriturat e Diamantit si portier aktiv janë: fitues i Superligës së Kosovës, fitues i Kupës së Kosovës dhe fitues i Superkupës së Kosovës, të gjitha këto të arritura me Feronikelin. Pas marrëveshjes së arritur me trajnerin e ri të portierëve, Diamant Kadriolli ka shfrytëzuar rastin ta falënderojë për angazhim ish-trajnerin Bekim Mulliqi, të cilit i ka dëshiruar suksese në vazhdim të karrierës.

# Shkodrani Hysen Zmijani kishte luajtur për ekipin e ri të Ronaldos





TIRANË, 4 JANAR - Al Nassr ka qenë prej ditësh kryefjalë e medieve botërore për shkak të kontratës së firmosur me futbollistin e njohur Cristiano Ronaldo. Megjithatë, jo të gjithë janë në dijeni të faktit që dikur me këtë skuadër luante dhe një futbollist i njohur shqiptar.
Bëhet fjalë për ish-futbollistin shkodran Hysen Zmijani. Ish-futbollisti ka luajtur për dy vjet me Al-Nassrin gjatë viteve '90, kohë në të cilën ekipi kishte arritur të fitonte dy kampionate. Zmijani ka dhënë një intervistë për "Abcnews", ku ka dhënë hollësi për këtë përvojë. Ai ka rrëfyer se arsyeja e kësaj lëvizjeje ishte trajneri i tij që ishte larguar nga Franca për në Arabinë Saudite.
Më tutje, Zmijani ka shpjeguar se dy vjet më pas është larguar nga ekipi arab për shkak se kishte marrë një ofertë nga Bundesliga. "Unë kam luajtur dy vjet në Korsikë në Francë. Kisha trajnerin, i cili iku në Arabi dhe ai më tërhoqi. Ne s'e kemi njohur Arabinë shumë nga futbolli dhe ndoshta ajo ishte pikënisja. Trajneri më mori, bëra kontratë një vit dhe ishin të gatshëm të bëja dhe një vit tjetër", ka thënë ai.
Megjithatë, për shkak të klimës, ai ka thënë se janë përballur me disa peripeci. Siç ka treguar ish-futbollisti shkodran, ata stërviteshin vetëm në darkë për shkak të temperaturave të larta. Mes të tjerash, ai është ndalur edhe te vendimi i Ronaldos, teksa ka thënë se e ka bërë për shkak të egos. "Është egoja e tij për të qenë më i pari në botë. Është më i paguari, një shembull për t'u marrë për të gjitha gjeneratat. Në Evropë ai e kishte të vështirë", ka thënë ai.

# Varroset Pele, mbi 230 mijë njerëz ia dhanë lamtumirën e fundit



SANTOS, 4 JANAR - Futbollisti legjendar brazilian Edson Arantes do Nascimento, i njohur si Pele, është varrosur pas një ceremonie dyditore në Brazil.
Pele ka ndërruar jetë më 29 dhjetor në moshën 82-vjeçare pas një beteje të gjatë me kancerin. Arkivoli i tij është transportuar në lagjen Santos, ku ai kishte bërë emër gjatë karrierës së tij, ndërsa mijëra tifozë të pikëlluar kishin dalë në rrugë për t'i dhënë lamtumirën tri herë kampionit të botës.
Pele është varrosur në katin e nëntë të varrezave me pamje nga stadiumi Santos, vendi ku ai ka bërë emër gjatë karrierës së tij. Trupi i tij është vendosur në një arkivol të hapur në tokën e Santos, ku është përcjellë nga djali i tij, Edinho, i cili ishte shumë i emocionuar gjatë ceremonisë. Më shumë se 230 mijë persona i kanë dhënë lamtumirën Peles, të cilët në dy ditët e fundit kishin ardhur për ta nderuar legjendën e madhe të futbollit. Megjithatë, vetëm anëtarët e ngushtë të familjes kanë marrë pjesë në varrim. Përflitet se vetë Pele ka zgjedhur katin e nëntë të varrezave për shkak të babait të tij, i cili gjatë kohës që luante futboll mbante mbi shpinë numrin 9.

# Totti po hetohet për riciklim parash me ndihmën e kazinove në Montekarlo e Las Vegas



Romë, 4 janar - Franchesko Totti ka përfunduar nën hetim dhe këtë radhë jo për të mësuar se ku ka zhdukur gjëra që i përkitnin ish-bashkëshortes së tij, Ilari Blazi. Mediet italiane kanë publikuar lajmet se ish-numri 10 i Romës po hetohet nga agjencitë kombëtare të luftës ndaj riciklimit të parave.
Gazeta "La Verita" ka bërë me dije se Totti ka përfunduar në llupën e hetuesve për "lëvizje të dyshimta parash" që nuk dihet se çfarë destinacioni real kishin. Një hipotezë është edhe ajo e investimeve në baste sportive të jashtëligjshme.
Burimet kanë treguar se ai ka dhënë hua 80 mijë euro duke kaluar këto para në llogarinë e një pensionisteje, teksa kjo shumë pastaj i kishte kaluar në të njëjtën ditë bashkëshortit të saj, mik i Tottit, tek një tjetër llogari personale e këtij personi. Nga kontrollet ishte zbuluar se në këtë llogari ishin bërë pagesa të shumta që kanë lidhje me operatorë të basteve online.
Hetimet e organeve italiane kanë nisur që në vitin 2020, kur janë marrë në shqyrtim dy llogari bankare të Tottit që kishin operuar me kazino në Montekarlo, Londër dhe Las Vegas. Sipas ekspertëve të organeve hetimore italiane, ka dyshime të mëdha mbi destinacionin e vërtetë të parave që kanë rrjedhur në adresë të këtyre kazinove, ndaj po kontrollohen të gjitha llogaritë bankare të Tottit.

## Messi kthehet si kampion bote te PSG-ja



Paris, 4 janar - Lionel Messi u ka dhënë fund pushimeve për suksesin në Kupën e Botës dhe për festat e fundvitit, duke u shfaqur përsëri në stërvitjen e PSG-së.
Klubi parisien e ka festuar në mënyrën më të mirë të mundshme kthimin e argjentinasit që tashmë ka bërë të vetin edhe trofeun që i mungonte në karrierë, Kupën e Botës.
Messi është pritur në qendrën stërvitore të PSG-së me një "tunel" ku pjesëtarë të stafit, lojtarët dhe personali i qendrës stërvitore ishte rreshtuar duke duartrokitur futbollistin argjentinas për arritjen e tij.
Më pas, Luis Kampos, drejtor i përgjithshëm i klubit, ia ka dorëzuar atij edhe një trofe të vogël me një yll të artë të vendosur mbi të.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for Human Resorces

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 04/01/2023 me nr ref: DBN 07/01/2023**,** Policia e Kosovës për të gjitha minoritet shpall:

## K O N K U R S

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas ).

**Vendi i punës: Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri.**

**A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kritere:**

a) Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
b) Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
c) Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
d) Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
e) Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
f) Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar);
g) Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

**B. Testet:**

a) Testi me shkrim;
b) Testi i aftësive fizike;
c) Intervista;
d) Testi psikologjik;
e) Kontrollimi mjekësor;
f) Verifikimi i të kaluarës.

**C. Forma e aplikimit:**

Aplikimi të bëhet në formën fizike që nënkupton se aplikacioni duhet të shkarkohet nga faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në adresën **www.kosovopolice.com / Shpallje/Mundësi punësimi** Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentet tjera mund dërgohet fizikisht në stacionin më të afërt të Policisë **ose** të dërgohet përmes postës elektronike (email) në adresën: **rekrutimi@KosovoPolice.com.**

**D. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:**

a) Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
b) Dëshmi për kualifikime tjera;
c) Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
d) Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime;
e) Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës
f) Një fotografi të formatit (5 x 5);
g) Dokumenti nga pika **c** dhe **d** të jenë të vlefshme dhe të nxirën pas datës së shpalljes së konkursit.

**E. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë**

a) Të mbrojë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat;
b) Të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
c) Të parandalojë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
d) Të parandalojë dhe t'i zbulojë veprat penale dhe kryesit e tyre;
e) Të hetojë veprat penale dhe kryesit e tyre;
f) Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë sigurinë në komunikacion;
g) Të menaxhojë dhe të kontrollojë kufirin shtetëror;
h) Të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
i) Të kryejë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë **nga data 05/01/2023 deri me datën 26/01/2023.**

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1554 apo 1722 si dhe në 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes se aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimeve do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolice.com dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

***"Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga këto minoritete".***

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/Department for Human Resorces

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o Radu Br. 03/L-212, poglavlje II, član 8,Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6,Zakona o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o radnom odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9 tačka 1 i 2, i Odluku Generalnog Direktora datuma: 04/01/2023 pod ref br: DLJI 07/01/2023**,** Policija Kosova za sve manjine objavi:

## K O N K U R S

Za prijem policijskih službenika po pretpostavkama konkursa za sve manjine (Serbi, Bošnjaci, Turci, Gorani Romi, Aškali, Egipcani, Hrvati, Crnogorci, Makedonci),

**Radno mesto: Regionalna Direkcija Policija Kosova Mitrovica Sever**

**A. Kandidati koji se prijavljuju za policijske službenike u Policiji Kosova moraju ispuniti sledeće kriterijume:**

a) Da bude Državljanin Republike Kosova ;
b) Imati 18-30 godina ;
c) Da ima završeno srednje obrazovanje ;
d) Da je u dobrom fizičkom, psihičkom, i emocionalnom stanju;
e) Da nije osudjivan za krivično delo ;
f) Da nema tetovažu na vidljivom mestu (lice, vrat, ruke );
g) Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti .

**B. Testovi :**

a) Pismeni test ;
b) Test fizičkih sposobnosti ;
c) Intervju ;
d) Psihološki test ;
e) Lekarski pregled ;
f) Provera prošlosti .

**C. Formular prijave :**

Prijave na konkurs za policijske službenike , biće na fizičkom obliku ,što podrazumeva da se aplikacija treba da se preuzima sa službene stranice PK : **www.kosovopolice.com / Oglas/Mogućnosti zapošljavanja, za popunjavanje.** Popunjena aplikacija zajedno sa ostalom dokumentacijom može da se dostavi u fizičkom obliku u najbližoj stanici policije **ili da se dostave skenirano preko email adrese:** **rekrutimi@Kosovopolice.com**

**D. Na aplikaciji , moraju biti priloženi zahtevani dokumenti uz prijavu kao što su :**

a) Kopija diplome o visokom , srednjem obrazovanju , dok za kandidate koji su obrazovanje završili u inostranstvo, overenu kopiju diplome ;
b) Dokaz o drugim kvalifikacijama ;
c) Izvod iz matične knjige rodjenih /izvod rodjenih ;
d) Uverenje od suda da nije osudjivan i da nije pod istragom ;
e) Kopija lične karte , ili pasoša
f) Fotografija formata (5 x 5);
g) Dokument iz tačaka **c i d** moraju biti validni i zacrnjeni nakon datuma objavljivanja konkursa .

**E. Dužnosti i opšte dužnosti Policije**

a) Da zaštiti život, imovinu i obezbediti sigurnost svih lica ;
b) Da štiti osnovna prava i slobode svih lica ;
c) Sprečavanje opasnost po gradjane i održavanje reda i javne bezbednosti;
d) Sprečavanje i otkrivanje krivičnih dela i njihovih izvršilaca ;
e) Da istražuje krivična dela i njihove izvršioce ;
f) Nadgleda i kontroliše bezbednost saobraćaja ;
g) Upravljati i kontrolisati državnu granicu ;
h) Pružanje pomoći tokom prirodnih katastrofa i drugih vanrednih slučajeva; i
i) Obavljati druge poslove predvidjene sa Zakonom o Policiji .

Zainteresovani kandidati mogu da apliciraju **od datuma 05/01/2023 do datuma 26/01/2023.**

Za detaljne informacije možete se obratiti na brojeve telefona t: 038-5080 lokalini : 1554 ili 1722 kao i na 038/245-184, od 09:00 do 15:00 časova .

Nakon selekcije prijava , uspešni kandidati će biti pozvani da učestvuju na gore navedenim testovima. Informisanje kandidata u vezi sa svakom etapom testova biće objavljene na zvaničnom sajtu Policije kosova , i na adresi: www.kosovopolice.com kao i na oglasnim tablama u relevantnim Regionalnim Direkcijama i Policijskim Stanicama .

***"Policija Kosova služi svim gradjanima Kosova. Ova služba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve gradjane Republike Kosova , i pozdravlja prijave svih muških i ženskih lica iz ovih manjina ".***

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje të Aktgjykimit nr. Ref AGJ. 1583/20 në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese datë 09 Korrik 2020, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr.06/L-055, nenit 39 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-054 Për Gjykatat, Nenit 9 Rregullore Nr. 04/2021 Për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional dhe Vendimit KGJK-së Nr. 512/2022 të datës 27 dhjetor 2022, shpall:

**KONKURS PUBLIK**
**PËR POZITËN BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL**
**NË GJYKATAT REPUBLIKËS SE KOSOVËS**

**NUMRI I POZITAVE TË SHPALLURA: - 40 pozita**

| Nr. Rendor | Gjykata / dega | Pozita | Numri i pozitave të lira |
|---|---|---|---|
| 1 | Gjykata e Apelit | Bashkëpunëtor profesional | 4 |
| 2 | Gjykata Komerciale | Bashkëpunëtor profesional | 6 |
| 3 | Gjykata Themelore Prishtine | Bashkëpunëtor profesional | 7 |
| 4 | GjTh Prishtinë - dega Podujeve | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 5 | GjTh Prishtinë - dega Lipjan | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 6 | GjTh Prishtinë - dega Gllogoc | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 7 | GjTh Prishtinë - dega Fushë Kosovë | Bashkëpunëtor profesional | 5 |
| 8 | Gjykata Themelore Prizren | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 9 | GjTh Prizren - dega Suharekë | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 10 | Gjykata Themelore Gjilan | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 11 | GjTh Gjilan - dega Viti | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 12 | GjTh Ferizaj - dega Kaçanik | Bashkëpunëtor profesional | 2 |
| 13 | GjTh Ferizaj - dega Shtërrpcë | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 14 | GjTh Pejë - dega Deçan | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 15 | Gjykata Themelore Gjakovë | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 16 | GjTh Gjakovë - dega Malishevë | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 17 | Gjykata Themelore Mitrovicë | Bashkëpunëtor profesional | 3 |
| 18 | GjTh Mitrovicë - dega Vushtrri | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| 19 | GjTh Mitrovicë - dega Skenderaj | Bashkëpunëtor profesional | 1 |
| | | **TOTALI I POZITAVE TË PUBLIKUARA** | **40** |

**PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS:**

**Titulli i pozitës së punës:** ***Bashkëpunëtor profesional;***

**Kategoria Funksionale:** *niveli profesional*
**Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti:** *Koeficienti - 9*
**Lloji i Vendit të Punës:** *pa afat të caktuar, me orar të plotë*
**Departamenti/Divizioni/Njësia:** *Zyra për Mbështetje Juridike në Gjykatë / zyra e Ndihmës administratorit në degë*
**Raporton tek:** *i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës dhe gjyqtarit me të cilin punon në Gjykatë / gjyqtarit me të cilin punon dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës në degë*
**Vlerësimi i performancës:** *nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me gjyqtarin me të cilin punon/ gjyqtarin me të cilin punon dhe Gjyqtari Mbikëqyrës në degë*
**Vendndodhja:** *Gjykatë /degë përkatëse*
**Procedura e aplikimit:** Konkurs i Jashtëm sipas Vendimit KGJK-së Nr. 512/2022
**Kohëzgjatja e kontratës së punës:** *Kontratë pune me afat të pacaktuar – përfshi periudhën provuese 6 muaj*
**Arsyeja e rekrutimit:** *plotësim i pozitave të lira sipas organogramit dhe planifikimit të punësimit për vitin 2022*

**Qëllimi i vendit të punës**: *(përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)*

Zyrtar me kompetence profesionale që i ofron mbështetje profesionale gjyqtarit, ndihmon në përgatitjen e memorandumeve, vendimeve të shkruara, aktgjykimeve, vendimeve të tjera, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike dhe duke bërë shqyrtimin e ligjeve.

**Detyrat Kryesore:** *(përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)*

- Me kërkesën e gjyqtarit me të cilin punon bënë përgatitjen e vendimeve gjyqësore (aktgjykime, vendime, urdhëresa dhe shkresa tjera) sipas udhëzimit të gjyqtarit;..........................................20%
- Përmes detyrave të caktuara nga gjyqtari me të cilin punon, bashkëpunëtori profesional kryen hulumtime ligjore, përpilimin e vendimeve gjyqësore;............................................................20%
- Prezanton në seanca gjyqësore duke marrë shënime dhe duke siguruar materiale të domosdoshme juridike;.....................................................................................................................10%
- Bën hulumtime në shqyrtimin e ligjeve dhe praktikave gjyqësore të dobishme për çështje të ndryshme;.................................................................................................................10%
- Kryen të gjitha detyrat e zyrtarit ligjor në rastet e mungesës së tyre dhe detyra tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë dhe gjyqtarit me të cilin punon;……………......…20 %
- Kryen të gjitha detyrat dhe veprimet me lëndën që i caktohen nga gjyqtari me të cilin punon përfshirë dhe të gjitha veprimet në SMIL;................................................................................10%
- Kryen edhe detyra tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi i dretëpërdrejtë dhe përgatitë raportet javore të punës...............................................................................10%

**Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës:** *(cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)*
- ***Nuk ka***

**Niveli i përgjegjësisë financiare:** *(p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)*
- ***Nuk ka***

**Shkathtësitë e kërkuara:** *(aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për ketë vend pune)*

- Të ketë njohuri profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore juridike....E nevojshme;
- Të ketë shkathtesi të deshmuara ndër personale per komunikim publik.....................E nevojshme;
- Të ketë shkathtesi hulumtuese, analitike, vleresuese dhe formulim te rekomandimeve dhe këshillave profesionale.............................................................................................E nevojshme;
- Të ketë aftesi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor...........................................................E nevojshme;
- Të ketë njohuri për sistemin dhe procedurat gjyqësore;..............................................E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,)...................E nevojshme;

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës**: *(kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për ketë vend pune)*

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik.................................E nevojshme;
- Provimi i Jurisprudencës i vlefshëm në Kosovë.........................................................E nevojshme;
- Minimum tri (3) vite përvojë pune juridike për Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale si dhe minimum dy (2) vite përvojë pune juridike për Gjykatat Themelore dhe degë e tyre dhe Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale......E nevojshme;

**Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka:** *(p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)*

- **Nuk ka**

**DOKUMENTET E NEVOJSHME**

1. Kandidatët në pajtim me nenin 10 Rregulloren Nr. 04/2021 Për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

**1.1.** Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
**1.2.** Çertifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
**1.3.** Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Republikën e Kosovës;
**1.4.** Çertifikatën e provimit të jurisprudencës, të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën
**1.5.** Dëshminë mbi përvojën e punës në fushën juridike, të përcaktuar me këtë rregullore dhe legjislacionin ne fuqi;
**1.6.** Çertifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të kandidatit; si dhe
**1.7.** Çertifikatën nga evidenca penale, e lëshuar nga gjykata;

2. Kandidati mund të dorëzojë edhe dokumentacionet si në vijim:

**2.1.** Publikime profesionale apo akademike; dhe/ose
**2.2.** Informata për pjesëmarrje në trajnime.

**NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR KANDIDATËT**

I. Neni 10 paragrafi 5 Rregulloren Nr. 04/2021 Për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, përcakton se procesit të rekrutimit kanë të drejtë t'i nënshtrohen vetëm kandidatët e regjistruar në Këshill, në afatin e paraparë me konkurs për aplikim dhe dokumentacion të kompletuar. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kritereve dhe kërkesave të konkursit nuk do të merren parasysh.

**FORMULARI I APLIKIMIT**

- formulari mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e KGJK-së. (**www.gjyqesori-rks.org**;)
- **Shkarko aplikacionin:**

**MËNYRA E APLIKIMIT**

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Këshill në formë fizike, përmes postës së rregullt ose postës elektronike: **KGJK.BurimetNjerzore@gjyqesori-rks.org;**
i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

**AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE**

Afati për dorëzimin e aplikacionit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, gjegjësisht deri me datën **13.01.2023**

- **Sekretariati i KGJK-së,**
- **Rruga ''Luan Haradinaj'' nr. 133, Prishtinë, në Zyrën e Pranimit.**
- **10000 Republika e Kosovës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Sudski savet Kosova, u skladu sa članom 108. Ustava Republike Kosovo, Zakonom o Sudskom savetu Kosova br. 06 / L-055, Zakonom o sudovima br. 06 / L-054, u skladu sa presudom br. Ref AGJ. 1583/20, u predmetu br. KO203/19, Ustavnog suda, Pravilnika (04/2021) i Odluke SSK br. 512/2022 od 27. decembar 2022. godine, raspisuje:

**JAVNI KONKURS**
**ZA POZICIJU STRUČNI SARADNIK**
**U OSNOVNIM SUDOVIMA REDPUBLIKE KOSOVA**
Broj objavljenih pozicija: tridesetpet (40)

| Redni broj | Sud / ogranak | Pozicija | Broj pozicija |
|---|---|---|---|
| 1 | Apelacioni Sud | Stručni saradnik | 4 |
| 2 | Privredni sud | Stručni saradnik | 6 |
| 3 | Osnovni sud - Priština | Stručni saradnik | 7 |
| 4 | O.S. Priština/ Ogranak Podujevo | Stručni saradnik | 1 |
| 5 | O.S. Priština/ Ogranak Lipljan | Stručni saradnik | 1 |
| 6 | O.S. Priština/ Ogranak Kosovo Polje | Stručni saradnik | 5 |
| 7 | O.S. Priština/ Ogranak Glogovac | Stručni saradnik | 1 |
| 8 | Osnovni sud - Prizren | Stručni saradnik | 1 |
| 9 | O.S. Prizren/ Ogranak Suva Reka | Stručni saradnik | 1 |
| 10 | Osnovni sud - Gnjilane | Stručni saradnik | 1 |
| 11 | O.S. Gnjilane/ Ogranak-Vitina | Stručni saradnik | 1 |
| 12 | O.S. Uroševac/ Ogranak-Kačanik | Stručni saradnik | 2 |
| 13 | O.S. Uroševac/ Ogranak-Štrpce | Stručni saradnik | 1 |
| 14 | O.S. Peć / Ogranak-Dečane | Stručni saradnik | 1 |
| 15 | Osnovni sud - Đakovica | Stručni saradnik | 1 |
| 16 | O.S. Đakovica/ Ogranak Mališevo | Stručni saradnik | 1 |
| 17 | Osnovni sud - Mitrovica | Stručni saradnik | 3 |
| 18 | O.S.Mitrovica / Ogranak - Vučitrn | Stručni saradnik | 1 |
| 19 | O.S.Mitrovica / Ogranak - Skenderaj | Stručni saradnik | 1 |
| | | **UKUPNO OBJAVLJENE POZICIJE** | **40** |

**OPIS RADNIH DUŽNOSTI:**

**Naziv radnog mesta:** ***Stručni saradnik ;***

**Funkcionalna kategorija:** *profesionalni nivo,*
**Stepen radnog mesta:/ Koeficijent:** *koeficijent devet (9)*
**Vrsta radnog mesta:** *neodređeno vreme, sa punim radnim vremenom,*
**Departman /Odsek/Jedinica:** *Kancelarija za pravnu podršku u sudu /kancelarija pomoćnika administratora u ogrankama*
**Izveštava:** *odgovara i izveštava rukovodiocu kancelarije i sudiji s kojim radi u sudu/sudiji s kojim radi i nadzornog sudiji u ogranku*
**Ocenjivanje radnog učinka:** *Rukovodilac kancelarije i sudije s kojim radi/ sudija s kojim radi i nadzornog sudiji u ogranku*
**Lokacija;** *Dotični sud/ ogranci*
**Prostupak apliciranja:** Javni konkurs Odluke SSK. 512/2022
**Trajanje ugovora o radu:** *Ugovor o radu na neodređeno vreme- uključujući probni period od 6. meseci*
**Razlog regrutacije:** *popunjavanje slobodnih pozicija na osnovu organizacione šeme i planiranja za zaposlenje za 2022. godinu*

**Cilj radnog mesta:** *(kratak opis svrhe pozicije i šta ova pozicija treba da postigne)*

Stručno osposobljeno službeno lice koje pruža stručnu podršku sudiji, pomaže u pripremi memoranduma, pismenih odluka, presuda, drugih odluka, obezbeđujući potreban pravni materijal i razmatranje zakona.

**Glavne dužnosti :** *(kratak opis glavnih dužnosti raspoređeno po važnosti i opis procenta vremena koje treba potrošiti na svaku dužnost)*

- Na zahtev sudije sa kojim radi, priprema sudske odluke (presude, rešenja, naredbe i druge dopise) po uputstvu sudije;..........20%
- Preko zadataka koje mu dodeli sudija sa kojim radi, stručni saradnik vrši pravna istraživanja, sačinjava sudske odluke……20%
- Prisustvuje u sudskim raspravama uzimajući beleške i obezbeđuje neophodne pravne materijale;……10%
- Vrši istrage na razmatranju zakona i sudskih praksi korisno za razna pitanja; ……10%
- Obavlja sve dužnosti pravnog službenika u slučajevima njegovog odsustva i druge poslove na zahtev neposrednog rukovodioca i sudije sa kojim radi;……..20%
- Obavlja sve dužnosti i radnje s predmetom koji se određuje od strane sudije s kojim radi uključujući i sve radnje u ISUP; ……......10%
- Obavlja i druge poslove u skladu sa važećim zakonodavstvom i normativnim aktima usvojenim od strane Saveta koje može opravdano zahtevati neposredni rukovodilac i priprema nedeljne izveštaje o radu……......10%

**Odgovornosti o nadzoru i ocenjivanju radnog učinka:** *(koje pozicije odgovaraju ovoj poziciji i kojim pozicijama obavlja ocenjivanje radnog učinka ova pozicija, ako ima)*

- *Nema*

**Nivo finansijske odgovornosti :** *(npr.budžet za koju je odgovorna dotična pozicija, nivo ovlašćenja za rashode)*

- *Nema*

**Potrebne veštine:** (*potrebne veštine i sposobnosti za ovo radno mesto*)

- Imati stručno znanje iz oblasti zakonodavstva i pravnih zakonskih akata…….. Potrebno;
- Imati dokazane međusobne veštine za javnu komunikaciju …….. Potrebno;
- Imati istraživačke, analitičke, vrednujuće veštine i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta ……. Potrebno;
- Imati sposobnost pisanja i pravno obrazloženje ……. Potrebno;
- Imati znanje o sistemu i sudskim postupcima……. Potrebno;
- Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel,)........Potrebno;

**Obrazovne i stručne kvalifikacije i radno iskustvo:** *(potrebna kvalifikacija i iskustvo za ovo radno mesto)*

- Važeća univerzitetska diploma na Kosovu: Pravni fakultet ........ Potrebno;
- Pravosudni ispit koji važi na Kosovu........ Potrebno;
- Najmanje tri (3) godine pravnog radnog iskustva za Vrhovni sud, Apelacioni sud i Drugostepenog veća Privrednog suda , kao i najmanje dve (2) godine pravnog iskustva za Osnovne sudove i njihove ogranke i veća Prvostepenenog veća Privrednog suda........ Potrebno;

**Neuobičajene karakteristike radne sredine ako postoje:** *(npr. ekstremne opasnosti na radnom mestu, fizički pritisak ili opasnosti od izlaganja opasnim materijama ili upotrebe opasne opreme koje proizilaze iz prirode radnog mesta ili lokacije radnog mesta).*

- **Nema**

**POTREBNI DOKUMENTI I NAČIN PODNOŠENJA PRIJAVE**

Kandidati, u skladu sa Pravilnikom 04/2021 o postupku regrutovanje i izbora stručnih saradnika, treba da dostave sledeća dokumenta:

1.1. Popunjenu prijavu sa zatraženim podacima;
1.2. Uverenje o državljanstvu Republike Kosova;
1.3. Važeću diplomu Pravnog fakulteta Republike Kosova;
1.4. Potvrdu o pravosudnom ispitu, priznat na osnovu važećeg zakona u Republici Kosova;
1.5. Dokaz o radnom iskustvu u pravnoj oblasti, kao što je utvrđeno ovim pravilnikom i zakonodavstvom na snazi;
1.5. Zdravstveno uverenje za procenu psiho-fizičkih sposobnosti; kao i,
1.6. Potvrdu iz kaznene evidencije izdate iz suda.

2. Kandidati mogu da dostave i sledeću dokumentaciju:

2.1. Stručne i akademske publikacije; i/ili
2.2. Informacije za pohađanje obuka.

Prijava za zapošljavanje zajedno sa pratećom dokumentacijom može se podneti Savetu u fizičkom obliku, putem redovne pošte ili elektronske pošte, koja se registruje i svaki kandidat dobija potvrdu o prijemu prijave za zapošljavanje

**VAŽNO OBAVEŠTENJE ZA KANDIDATE**

Član 10. stav 5. Pravilnika 04/2021 utvrđuje da postupku regrutacije imaju pravo da podlegnu samo kandidati registrovani u Savetu, u roku predviđen konkursom za prijavu i uz kompletnu dokumentaciju. Dok kandidati koji se nisu prijavili u roku predviđen konkursom, kao i oni koji su se prijavili u roku, a nisu dostavili kompletnu dokumentaciju prema kriterijumima i uslovima konkursa, neće biti uzeti u obzir.

**OBRAZAC ZA PRIJAVU**

- obrazac se može preuzeti sa zvanične stranice SSK-a. (www.gjyqesori-rks.org)

Preuzmi prijavu

Podnošenje prijave elektronskim putem se vrši slanjem dokumentacije (prijave i prateća dokumenta) na elektronskoj adresi: KGJK.BurimetNjerzore@gjyqesori-rks.org;

**ROK ZA PODNOŠENJE PRIJAVE**

Rok za podnošenje prijave je petnaest (15) dana od dana raspisivanja konkursa, odnosno do dana **13.01.2023**

- **Sekretarijat SSK-a,**
- **Ulica ''Luan Haradinaj'' br. 133, Priština, u Kancelariji za prijem.**
- **10000 Republika Kosova**











## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues